



Oda e Stomatologëve të Kosovës
Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosovo

KUVENDI I ODËS STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS (OSK-së) në mbështetje të Nenit 19, paragrafi 1 me nën-paragrafin 1.12 dhe 1.13 të Lgjit 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor; Nenit 20, paragrafi 1 me nën-paragrafin 1.12, 1.13 dhe 1.14 të Statutit të Odës së Stomatologëve të Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me 30 tetor 2021, nxjerrë këtë:

V E N D I M

**PËR CAKTIMIN E LARTËSISË SË TAKSAVE ADMINISTRATIVE NË
OSK**

(Teksti i spastruar me plotësime dhe ndryshime të miratuara nga Kuvendi i OSK-së,
me datë 30 tetor 2021)

Neni 1

Taksat administrative për identifikim dhe regjistrim

Të gjithë anëtarët e Odës për rrethanat e mëposhtme janë të obliguar të paguajnë taksat administrative si në vijim:

- 1.1 Për regjistrim në regjistrin e anëtarëve të Odës, në shumën prej 5.00 €
- 1.2 Për ri regjistrimin e dytë në regjistrin e anëtarësisë së Odës, në rastin kur është larguar nga regjistri i anëtarësisë pas shqiptimit të masës disiplinore, në shumën prej 100.00 €.

- 1.3 Për aplikim për ndërrim të kartelës për shkak të ndërrimit të statusit profesional apo për shkak të humbjes, dëmtimit të kartelës së anëtarësisë së Odës në shumën prej 5.00 €.

Neni 2

Kuota e anëtarësisë vjetore për stomatologët të cilët ushtrojnë veprimtarinë stomatologjike në Republikën e Kosovës

- 2.1 Kuota e anëtarësisë vjetore për stomatologët e punësuar në institucione publike dhe private, specializantët me kontratë pune apo me subvencion nga Ministra e Shëndetësisë dhe stomatologët nga lugina e Preshevës, në shumë prej 50.00 €.
- 2.2 Kuota e anëtarësisë vjetore për stomatologët e papunë shtetas kosovarë, specializantët pa kontratë pune apo pa subvencion nga Ministra e Shëndetësisë, stomatologët e papunë nga lugina e Preshevës, është në shumën prej 25.00 €. Duhet sjellur dëshmi/ vërtetimi nga ATK se nuk kanë deklaruar të hyra për vitin kalendarik kur bëhet pagesa e kuotës së anëtarësisë.
- 2.3 Stomatologët e pensionuar që ushtrojnë veprimtarinë stomatologjike paguajnë kuotën e anëtarësisë në shumë prej 25.00 €.
- 2.4 Kuota e anëtarësisë vjetore për stomatologët e huaj që ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Kosovës në shumë prej 150.00 €.

Neni 3

Mënyra e ekzekutimit të pagesës së kuotës së anëtarësisë vjetore

- 3.1 Pagesa e kuotës së anëtarësisë vjetore bëhet jo më larg se 30 qershor të vitit kalendarik përmes sistemit të pagesave të OSK-së.
- 3.2 Në rastet kur pagesa e kuotës së anëtarësisë vjetore bëhet pas afatit të paraparë nga paragrafi paraprak i këtij neni, do të aplikohet taksa shtesë prej 5 euro për çdo muaj vonesë.

- 3.3 Anëtarët e Odës, të cilët nuk kanë bërë pagesën e kuotës së anëtarësisë për vitin 2020 dhe 2021, taksa shtesë prej 5 euro për çdo muaj vonesë nuk do të aplikohet, nëse ata i përmbushin obligimet deri me datë 31.12.2021.

Neni 4

Taksat administrative për licencim dhe rilicencim dhe vlerësim në EVP

- 4.1 Taksa administrative për parashtrimin e aplikacionit për valorizim të pikëve kredituese të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional në shumë prej 5.00 €.
- 4.2 Taksa administrative për dhënie të licencës së punës në shumë prej 100.00 € për kohëzgjatje prej 5 (pesë) viteve.
- 4.3 Për ekzemplarën e dublikimit të licencës së punës në shumën prej 15.00 €.
- 4.4 Për parqitjen e provimit vlerësues të njohurive/shkathtësive për stomatologët të cilët kanë mungesë të pikëve akredituese nga 5- 40 pikë, në shumë prej 200 €.
- 4.5 Për parqitjen e provimit vlerësues të njohurive/shkathtësive për stomatologët të cilët kanë mungesë të pikëve akredituese nga 50- 100 pikë, në shumë prej 300 €.
- 4.6 Për lëshim të faksimilit, në shumën prej 15.00 €.

Neni 5

Taksa administrative për organizim të eventeve të ndryshme

- 5.1 Taksa administrative për aplikim të organizimit të eventeve të ndryshme profesionale në shumë prej 200.00 €.
- 5.2 Për çdo certifikatë të lëshuar 10 % e vlerës së kuotizimit të eventit, në llogari të Odës.

Neni 6

Taksat administrative në procedurën e mbikëqyrjes etike

- 6.1 Për lëshimin e certifikatës për të kaluarën etike për përdorim brenda apo jashtë vendit në shumën prej 30.00 €.

- 6.2 Taksa sipas pikës 6.1 është e vlefshme në afat kohor prej 6 (gjashtë) muaj nga data e lëshimit të certifikatës (vërtetimit).

Neni 7

Taksat e përgjithshme administrative

Për nevojat personale të anëtarëve të OSK-së lidhur me lëshimin e dokumenteve të ndryshme, përcaktohen taksat administrative si në vijim:

- 7.1 Për dokumente dhe certifikatat e lëshuara për përdorim brenda Republikës së Kosovës në shumë prej 5 €.
- 7.2 Taksa administrative për dokumente dhe certifikata të lëshuara për përdorim jashtë territorit të Republikës së Kosovës në shumë prej 25.00 €.

Neni 8

Taksat administrative për dhënien e lejes për hulumtime bio-mjekësore

Aplikuesit për dhënien e lejit për hulumtime bio-mjekësore, persona fizikë apo juridikë, do të jenë të obliguar që të paguajnë taksën administrative si në vijim:

- 8.1 Për anëtarë të OSK-së, qytetar të Republikës së Kosovës në shumën prej 150.00€.
- 8.2 Për jo-anëtarë të OSK-së, qytetarë të Republikës së Kosovës në shumën prej 350.00€.
- 8.3 Për qytetarë jo-kosovar, dhe jo-anëtarë të OSK-së në shumën prej 400.00€;
- 8.4 Për persona juridik organizata jo-profesionale të regjistruara në Republikën e Kosovës në shumën prej 150.00€
- 8.5 Për persona juridik organizata profitabile të regjistruara në Republikën e Kosovës në shumë prej 400.00€.
- 8.6 Për persona juridik organizata ndërkombëtare që nuk janë të regjistruara në Republikën e Kosovës dhe nuk janë në mardhënie partneriteti me njësitë e qeverisë së Kosovës në shumën prej 350.00€.

- 8.7 Organi kompetent i cili lejon hulumtimin, cakton taksën administrative varësisht nga kategoria e përcaktuar me paragrafet e këtij neni.

Neni 9

Ekzekutimi i taksave administrative

- 9.1 Taksa administrative sipas nenit 4, nenit 5, nenit 6 dhe nenit 8 nuk kthehet në rast të refuzimit të lëndës nga organi kompetent i Odës.

Neni 10

Pasojat juridike për shkelje të obligimit të anëtarësisë

Të gjithë stomatologët që nuk i kryejnë obligimet lidhur me pagesën e kuotës së anëtarësisë, Komisioni për Anëtarësim, Licencim dhe Rilicencim i OSK-së, përmes Vendimit të formës së prerë do të ndërpres anëtarësimin në OSK sipas Statutit të OSK-së, Neni 12, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4.

Neni 11

Hyrja në fuqi

- 11.1 Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha dispozitat e mëhershme që kanë përcaktuar lartësinë e taksave administrative të Odës.
- 11.2 Ky vendim hyn në fuqi prej datës 1 janar 2022.

Prishtinë,
30 tetor, 2021



Kryetari i OSK-së
Prof. Dr. Blerim Kamberi




Oda e Stomatologëve të Kosovës
Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosovo

KUVENDI I ODËS SË STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS (OSK), në mbështetje të Nenit 19, paragrafi 1 me nën-paragrafi 1.1 dhe 1.13 të Ligjit 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Neni 20, paragrafi 1 me në-paragrafin 1.1 dhe 1.13 të Statutit të Odës së Stomatologëve të Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me 12/11/2022, nxjerrë këtë:

VENDIM

- I. MIRATOHET shfuqizimi i pjesërishtëm i Vendimit për Caktimin e lartësisë së taksave administrative në OSK me nr. prot. 2036 të datës 02.11.2021, si më poshtë:
1. Fshihet paragrafi 1.1 i Nenit 1 me këtë përmbajtje: “Taksa administrative për regjistrim në regjistrin e anëtarëve të Odës, në shumën prej 5.00 €”;
 2. Fshihet paragrafi Paragrafi 4.1 i Nenit 4 me këtë përmbajtje: “Taksa administrative për parashtrimin e aplikacionit për valorizim të pikëve kredituese të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional në shumë prej 5.00 €.”
 3. Fshihet Paragrafi 7.1 i Nenit 7 me këtë përmbajtje: “Taksa administrative për lëshimin e dokumente dhe certifikatat për përdorim brenda Republikës së Kosovës në shumë prej 5 €.”
- II. Ky vendim hun në fuqi nga data 01.01.2023.

Prishtinë, 12 nëntor 2022

Kryetari i OSK-së

Prof.Dr. Blerim Kamberi

